

Njoftim për publikimin e sondazhit online

Titulli: “Sondazhi online për mbledhjen dhe identifikimin e prioriteteteve/rekomandimeve të qytetareve që mund të perfshihen në buxhetin afatmesem 2022

Propozuesi: Sondazhi është propozuar nga Komisioni i Ekonomisë dhe Buxhetit të KB Kolonje.

Sqarime/ Detaje: Sondazhi online bazohet mbi të dhënat e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të bashkisë për vitin 2020. Qëllimi i këtij sondazhi është të mblidhen sugjerimet e komunitetit lidhur me:

- Mënyrën si janë shpenzuar fondet për ofrimin e shërbimeve nga bashkia.
- Performancën e shërbimeve të ofruara nga bashkia.
- Shërbimet prioritare të komunitetit.

Kalendari i konsultimit: Mbledhja e mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit do të bëhet përmes platformës elektronike të sondazhit online. Sondazhi do të jetë online deri në 30 Nëntor 2021.

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë:** Kryetarët e të gjithë Komisioneve të Këshillit të Bashkisë, Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, këshilltarë, drejtues/punonjës të administratës që lidhen me çështjen që konsultohet.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias dhe akademisë, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë.

Format e konsultimit: Pyetësor online. Sondazhi aksesohet në linkun:

<https://forms.office.com/Pages/ResponsePage.aspx?id=DQSIkWdsW0yxEjajBLZtrQAAAAAAAAAAAAAYAAI BWQCRUQkhTTkpBMzdHMk9ISFdOMUZSSzZEU1A5My4u>

Këshillimi publik përmes sondazhit online synon tërheqjen e mendimit të qytetarëve, biznesit, shoqërisë civile, medias dhe akademisë lidhur me prioritetet që kanë për shërbimet / funksionet e ofruara nga Bashkia. Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komunitetit, kërkon të marrë më shumë

<p>Qëllimi i këshillimit publik</p>	<p>informacion mbi mendimin e komunitetit për përdorimin e fondeve publike për ofrimin e shërbimeve nga ana e Bashkisë, performancën e ofrimit të shërbimeve si dhe cilët janë shërbimet / funksionet që konsiderohen prioritare nga komuniteti. Duke qenë se sondazhi është i aksesueshëm online, aksesueshmëria e tij është e gjerë dhe mundëson gjithëpërfshirjen e komunitetit, pavarësisht vendndodhjes së tyre, në çdo kohë.</p> <p>Mbledhja e mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit, do t'i shërbejë Këshillit për të përcaktuar se si do të përdoren fondet publike në ofrimin e shërbimeve për tre vitet e ardhshme 2022 – 2024, dhe të sigurojë që përdorimi i tyre është në përputhje me nevojat e komunitetit për përmirësimin e shërbimeve prioritare të përcaktuar nga to.</p>
<p>Përshkrimi i çështjes që trajton sondazhi online</p>	<p>Miratimi i projekt buxhetit afatmesëm është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë.</p> <p>Për këtë, Këshilli i Bashkisë ka përgatitur dhe publikuar një sondazh online i cili ofron të dhëna informuese mbi mënyrën sesi janë përdorur fondet gjatë vitit 2020, nivelin e arritjes së objektivave të shërbimeve, si dhe ofron një listë me shërbime / funksione të cilat janë financuar me më pak se 2% të buxhetit të vitit 2020, nga e cila komuniteti përzgjedh ato shërbime për të cilat mendon se bashkia duhet të shpenzojë më shumë gjatë tre viteve të ardhshme.</p>
	<p>Këshilli i Bashkisë ka marrëraportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2020 dhe ka përgatitur një pyetësor bazuar në të dhënat që përmban ky dokument. Bazuar në Ligjin 139/2015 Neni 18, ka vendosur kalimin në konsultim publik për përgatitjen e projekt buxhetit afatmesëm duke përdorur sondazhin online.</p> <p>Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A jeni dakort me mënyrën si janë shpenzuar paratë? Shprehni

<p>Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut</p>	<p>opinionet tuja në lidhje me këtë?</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Prioritet e publikut: Zgjidhni ato shërbime për të cilat mendoni se duhet shpenzuar më shumë (2% ose më pak është shpenzuar) 3. A jeni të gatshëm të paguani me shumë taksa dhe tatime për ofrimin e shërbimeve shtesë që keni përzgjedhur më lart? 4. Nese do e vlerësonit performancën e bashkisë tuaj, çfarë note do i jepni nga 0 në 10 për vitin 2020?
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen direkt nëpërmjet votimit në platformën e sondazhit online, BRENDA DATËS 30.11.2021.</p> <p>Sondazhi aksesohet mund të aksesohet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në adresën zyrtare të internetit të Këshillit të Bashkisë Kolonje, në linkun: https://www.kolonja.gov.al/notices/sondazh-nga-keshilli-i-bashkise-kolonje/ • Në facebook zyrtar të Këshillit të bashkisë; • Në adresën zyrtare të internetit të Bashkisë, Programi i Transparencës, në linkun: https://www.kolonja.gov.al/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje-2/ <p>Për çdo vështirësi apo paqartësi lidhur me sondazhin, mund të kontaktoni drejtpërdrejtë me Sekretarin e Këshillit të Bashkisë:</p> <p>Email: katerinailia189@yahoo.com</p> <p>Adresa: Këshilli i Bashkisë, Bashkia Kolonje, Erseke.</p>
<p>Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme</p>	<p>Opsionet e mundëshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit :</p> <p>Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.</p>
<p>Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet</p>	<p>Raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2020 mund ta gjeni në linkun https://www.kolonja.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Relacion-Raport-Monitorimi-2020-Bashkia-Kolonje.pdf</p>
<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të</p>	<p>Konsultimi publik përmes sondazhit do të jetë i munduar deri në 30 Nëntor 2021, por mbledhja dhe shqyrtimi i rekomandimeve do bëhet në disa faza:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rekomandimet e ardhura deri në 15 Maj 2021;

<p>ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rekomandimet e ardhura deri në 30 Nëntor 2021. <p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të Sondazhit, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje. 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës dhe çdo këshilltari të bashkisë. 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë. 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit. 6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre. 7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit 8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar 9. Monitorimi i zbatimit të tij
<p>Data e publikimit</p>	<p>12/04/2021</p>